



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS VITI

Numri i lëndës: 2018:019123

Datë: 17.01.2019

Numri i dokumentit: 00207242

P.nr.359/2017
NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS VITI DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM DIVIZIONI PENAL Sipas gjyqtarit Skender Shefkiu, me zyrtaren ligjore Lumturije Fetahu duke vendosur në qështjen penale kundër të akuzuarve xxx xxx nga fsh.xxxx K.xxx për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 , paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 nën paragrafi 1.4 të KPRK-së dhe xxxit xxxi nga fshxxxx K.xxxx për shkak të veprës lëndim i lehtë trupor nga neni 188 , paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të KPRK-së, sipas aktakuzës të PTHSH nga Gjilani, PP.II.nr.xxx e dt. xxxx pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar e publik të 08.01.2019 ndërsa me datën 09.01.2019 mori dhe shpalli publikisht këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari xxxxx nga babai Nxxxx, nëna xxxxi vajzërisë xxxx i lindur xxxx në fsh.xxxxë K.xxx ku edhe jeton , te kryer xxx , i pa pune , i pa martuar, me gjendje të varfur ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës se Kosovës.

I akuzuari xxx nga babai xxxx ,nëna xxxx, i vajzeris xxxxx i lindur xxxx në xxxx tani me vendbanim në fsh.xxx K.xxxx, te kryer shkollën xxxx , i pa punësuar, i pa martuar, , me gjendje të varfur ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës se Kosovës.

JANË F A J T O R Ë

I akuzuari xxxxx xxxxxx

I

Sepse me datën xxx korrik xxxx , rreth orës xxx, në rrugën ‘xxxxxx ‘ në xxxxi pandehuri xxxxx , për shkak të një mosmarrëveshje , me dashje i ka shkaktuar lëndime trupore të dëmtuarit Xh. A., N.n .. I. A..dhe N.xxxxx ashtu që fillimisht me grushta dhe me pas me një shifër druri , mjet ky i përshtatshëm për shkaktimin e lëndimeve të rënda trupore me veprimet e veta i ka shkaktuar lëndime të rënda trupore , i ka goditur disa herë të dëmtuarit X.t A.i , N. A.dhe I. A... të cilët për shkak të lëndimeve janë detyruar të kërkojnë ndihmë mjekësore në Emergjencën e Spitalit Regjional të Gjilanit.

-me çka ka kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 nën paragrafin 1.4 të KPRK-së.

I akuzuari xxx xxxx

II

Sepse me datën xxxx korrik xxx , rreth orës xxx në rrugën , 'xxx x ' në xxxx i pandehuri E.I. , për shkak të një mosmarrëveshje , me dashje i ka shkaktuar lëndime trupore të dëmtuarit Xh. A., N.n A. , I. A. dhe N. A., ashtu që me grushta , i ka goditur disa here të dëmtuarit në kokë dhe në pjesë të ndryshme të trupit , kështu që i pandehuri me veprimet e veta i ka shkaktuar lëndime të lehta trupore të dëmtuarëve , Xh.. A. , N.A. dhe xxxxx. A.të cilët për shkak të lëndimeve janë detyruar të kërkojnë ndihmë mjekësore në Emërgjencën e Spitalit Regjional të Gjilanit.

-me çka ka kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 paragrafi 1 lidhur nën paragrafin 1.4 të KPRK-së

Gjykata duke u bazuar në këto dispozita ligjore të nenit 7,17, 21, 41, 45,46, 47 .74 e 83 të KPRK-ës si dhe nenit 360, 361,365 të KPPRK-ës.

I GJYKON

I. Të akuzuarin xxxxxxxx xxxx me dënim burgu në kohëzgjatje prej 2 (dy) muaj i cilin dënim do të ekzekutohet pasi që aktgjykimi të bëhet i formës së prerë .

Sipas marrëveshjes për pranimin e fajësisë , konform nenit 47 të KPRK-ës, dënimi i shqiptuar me burg, i zavedësohet me dënim gjobe në shumë prej **700 € (shtatëqind) euro** të cilin dënim është i obliguar që ta paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

II. Të akuzuarin xxxxxxxx xxxx me dënim burgu në kohëzgjatje prej 1 (një) muaj i cilin dënim do të ekzekutohet pasi që aktgjykimi të bëhet i formës së prerë .

Sipas marrëveshjes për pranimin e fajësisë , konform nenit 47 të KPRK-ës, dënimi i shqiptuar me burg, i zavedësohet me dënim gjobe në shumë prej **600 € (gjashtëqind) euro** të cilin dënim është i obliguar që ta paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

III. Në bazë të nenin 83 të KPRK-se në dënimin e shqiptuar për të akuzuarin xxx x xxx do ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës **xxxx deri me datën xxxxx** , ndërsa për të akuzuarin xxxxxxxx do ti llogaritet edhe koha e kaluar në arrestit shtëpiak prej datës. **xxxxx deri me xxxxx**

IV. Konform nenit 39 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 të ligjit për Kompensimin e Viktimave të krimit të akuzuarve i shqiptohet taksa në shumë prej nga **30€**.

Të dëmtuarit xxxxxxxx xxxxxxx, xxxxxxx i që të gjithë nga xxxx rruga ,,xxxxxx pa.nr. për realizimin e kërkesës pasuror juridike udhëzohen në kontest civil.

Obligohet të akuzuarit që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën secili nga **30 €** gjithashtu në afat prej 15 ditësh nga plotëfuqishmëria e këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore nga Gjilani, Departamenti i Përgjithshëm, ka ushtruar aktakuzë PP.II.nr.xxxx të datës xxxx ka akuzuar të akuzuarit akuzuarve xxxxx nga fsh.Sxxxx K.xxxx për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 , paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 nën paragrafi 1.4 të KPRK-së dhe xxxxx xxxxxx nga fsh.xxxx K.xxxx për shkak të veprës lëndim i lehtë trupor nga neni 188 , paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të KPRK-së, duke propozuar që të shpallen fajtor dhe të dënohen në bazë të ligjit.

Para mbajtjes se shqyrtimit fillestar të datës 14.08.2017 gjykatës i është dorëzuar se bashku me aktakuzën edhe një marrëveshje për pranimin e fajësisë e lidhur në mes të Prokurorisë Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, në njërën anë dhe të akuzuarve xxx,xxx dhe mbrojtësit të tij, avokatit Idriz Syla , nga Vitia , në anën tjetër, dhe të akuzuarit xxxxx dhe mbrojtësi të tij av.Kadri Sylaj nga Gjilani . Sipas kësaj marrëveshje, kësaj Gjykate, i është rekomanduar që ndaj të akuzuarit xxxxx , për shkak të kryerjes së veprës penale të lartcekur t'i shqiptohet dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) muaj . Me pëlqimin e të akuzuarit të njëjtit i mundësohet që dënimi i shqiptuar me burg i zëvendësohet me dënim me gjobë në shumë prej 700 (shtatëqind) euro , ndërsa ndaj të akuzuarit xxxxx për shkak të kryerjes së veprës penale të lartcekur t'i shqiptohet dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) muaj . Me pëlqimin e të akuzuarit të njëjtit i mundësohet që dënimi i shqiptuar me burg i zëvendësohet me dënim me gjobë në shumë prej 600 (gjashtëqind) euro.

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, të mbajtur më datën 01.8.2019 gjyqtari pas dëgjimit të palëve dhe të mbrojtësve e ka pranuar marrëveshjen për pranimin e fajësisë, ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt, gjykata ka konstatuar se të akuzuarit e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë; se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga të akuzuarit , pas konsultimeve e të mjaftueshme, me mbrojtësin e tyre , avokatin Idriz Syla dhe av.Kadri Sylaj , se të akuzuarit nuk kanë qenë të detyruar ose të shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojnë fajësinë, se pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe se nuk ekzistojnë asnjë nga rrethanat e parapara në nenin 253 paragrafët 1 dhe 2 të KPPK.

Pra një gjendje të këtyre faktive të pa kontestuar gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit xxxxx xxx , egzistojn të gjitha elementet qenësore të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 , paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 nën paragrafi 1.4 të KPRK-së dhe xxxxx të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 , paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të KPRK-së ishin të vetëdijshëm mbi veprimet inkriminuese si dhe pasojën e ndaluar të cilën e kanë dëshiruar.

Gjykata me rastin e shqyrtimit të dënimit, ka vlerësuar se duhet të aprovohet rekomandimi i paraqitur në marrëveshjen për pranimin e fajësisë që ndaj të akuzuarve xxx xxxx për veprën penale të përshkruar në dispozitivin I të kësaj aktakuze dhe i shqiptoi dënimin me gjobë në shumë prej 700 (shtatëqind) euro dhe xxxxx për veprën penale të përshkruar në dispozitivin II të kësaj aktakuze dhe i shqipton dënimin me gjobë në shumë prej 600 (gjashtëqind) euro të cilat dënime janë të obliguar që ti paguajnë në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi .

Me rastin e caktimit të lartësisë dhe llojit të dënimit, gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat e parapara konform nenit 74 të KPRK-së, si rrethanë lehtësuese mori faktin e marrëveshjes së

pranimet të fajësisë, pendimin dhe premtimin e tij se në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale, janë të meshës së re, se më parë nuk kanë qenë të dënuar, janë të pa punë, me të dëmtuarit janë pajtuar, si rrethanë rënduese mori faktit se veprat e këtij lloji janë të manifestuara me një numër më të madh dhe paraqesin rrezikshmëri të përgjithshme shoqërore si dhe dëmin e shkaktuar të dëmtuarve.

Lidhur me kërkesën pasurore –juridike është vendosur konform nenit 463 të KPPRK-së. Vendimi mbi paushallin gjyqësor është bazuar konform nenit 450 të KPPRK-së.

**GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS VITI
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL
P.nr.359/2017
2018:019123, 08.01.2019**

Zyrtarja ligjore
Lumturije Fetahu

Gjyqtari
Skender Shefkiu

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimet të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.